Për zyrtarët e nivelit të mesëm drejtues sipas nenit 31, dhe për zyrtarët e parashikuar në nenin 32 të kreut të III, seksioni 2 të këtij ligji, ndalimi sipas pikës 1 të këtij neni, për shkak të interesave private të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave në fushën e territorit dhe të juridiksionit të institucionit, ku punon zyrtari. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë është një institucion i varësisë.

Kur zyrtari është në funksionin e kryetarit a të nënkryetarit të bashkisë, komunës ose të këshillit të qarkut, të anëtarit të këshillit përkatës ose është zyrtar i nivelit të lartë drejtues të një njësie të qeverisjes vendore, ndalimi për shkak të interesave privatë të zyrtarit, të përcaktuara në këtë pikë, zbatohet vetëm në lidhjen e kontratave, sipas rastit, me bashkinë, komunën ose këshillin e qarkut, ku zyrtari ushtron këto funksione. Ky ndalim zbatohet edhe kur palë në kontratë është një institucion publik, në varësi të kësaj njësie (neni 21 pika 2 e Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005).

Ndalimet e përcaktuara në nenin 21 pika 1, 2 të Ligjit Nr. 9367, datë 07.04.2005, me përjashtimet përkatëse, zbatohen në të njëjtën masë edhe për personat e lidhur me zyrtarin që në kuptim të këtij ligji janë

bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi, fëmijë në moshë madhorë, prindërit e zyrtarit të bashkëshortit/es dhe bashkëjetuesit/es.

Unë i nënshkruari _____, me cilësinë e përfaqësuesit të personit juridik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time personale se:

Jam në dijeni të kërkesave dhe ndalimeve të përcaktuara në Ligjin Nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” i ndryshuar, si dhe në aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive si dhe të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Në përputhje me to deklaroj se asnjë zyrtar i përcaktuar në **Kreun III, Seksioni II** të Ligjit Nr. 9367, datë 7.4.2005, dhe në këtë deklaratë, nuk zotëron interesa private në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë me personin juridik që unë përfaqësoj.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

Shtojca 7

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik*]

DEKLARATË MBI PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME

Deklaratë e operatorit ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilesinë _____ të operatorit ekonomik _____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- Operatori ekonomik _____ është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.
- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar për asnjë nga veprat penale, të parashikuara Nenin 45/1 të LPP.
- Personi/at në cilësinë e *anëtarit të organit administrativ, drejtuesit ose mbikëqyrësit, aksionerit ose ortakut, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda operatorit ekonomik*, si më poshtë:

Nr.	Emër (Emrat)	Mbiemër	Datëlindje ditë muaj vit	Atësi	Amësi	Vendlindje
1						
2						
3						

nuk janë ose kanë qenë të dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për asnjë nga veprat penale, të përcaktuara në nenin 45/1 të LPP³.

- Operatori ekonomik _____ nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- Operatori ekonomik _____ nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv).
- Operatori ekonomik _____ ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatorit ekonomik si më sipër.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Nënshkrimi i ofertuesit _____

Vula _____

³ Autorizoj Autoritetin Kontraktor të bëjë verifikimet përkatëse të gjendjes gjyqësore të personave të deklaruar në këtë Deklaratë.

Shtojca 7/1

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Operatori Ekonomik]

DEKLARATË MBI GARANTIMIN E ZBATUESHMËRISË SË DISPOZITAVE LIGJORE NË MARRËDHËNIET E PUNËS

Deklaratë e Operatorit Ekonomik pjesëmarrës në procedurën e prokurimit që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____ me cilësinë e _____ të operatorit ekonomik _____, **deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:**

- Operatori ekonomik _____ garanton mbrojtjen e të drejtës së punësimit dhe profesionit nga çdo formë diskriminimi, të parashikuar nga legjislacioni i punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ lidh me punëmarrësit kontratat përkatëse të punës dhe garanton masat në drejtim të sigurisë dhe shëndetit në punë për të Gjithë dhe, në mënyrë të veçantë, për grupet e rrezikuara, bazuar në legjislacionin e punës në fuqi.
- Operatori ekonomik _____ nuk ka masë Ligjore në fuqi, të vendosur nga Inspektoriati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore (ISHPSHSH). Në rastet kur janë konstatuar shkelje ligjore, operatori ekonomik ka marrë masat e nevojshme për adresimin e tyre, brenda afateve të përcaktuara nga ISHPSHSH.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Përfaqësuesi i ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

LOTI I "MIRËMBAJTJE OBJEKTI NDËRTIMOR PËR MINISTRINË E FINANCAVE DHE EKONOMISË"

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;

dh. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

2. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001 ose ekuivalente**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 18001 / ISO 45001 ose ekuivalente**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të mjedisit, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 14001 ose ekuivalente**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme ISO, sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes, në përputhje me nenin 74 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014, i ndryshuar.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar **në tre vitet e fundit 2018, 2019 dhe 2020**, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të Lotit 1.
2. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë kopje të certifikuar të bilanceve **të tre viteve të fundit (2018, 2019 dhe 2020)**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. *Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.*

2.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej minimalisht 40% të

Dokumentat standarde të tenderit

vlerës së fondit të marrëveshjes kuadër. Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, kur këto shërbime të ngjashme janë realizuar me institucione publike.
 - b) faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat dhe shumat për shërbimet e realizuara, kur këto shërbime të ngjashme janë realizuar me subjekte private.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:
- NP 3-A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar, **3 (tre) muajt e fundit referuar listëpagesës, mesatarisht 9 punonjës, për periudhën Janar-Mars 2021**. Për të provuar pasjen e tyre, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:
- a) Listëpagesat e deklaruara të punonjësve, sipas formatit E-Sig 025/a, për periudhën **Janar-Mars 2021** të konfirmuara nga administrata tatimore.
 - b) Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lëshuar nga administrata tatimore, për periudhën **Janar-Mars 2021**.
4. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik, të punësuar me kohë të plotë referuar listëpagesës, për periudhën **Janar-Mars 2021** minimalisht :
- a) **1 (një) punonjës të trajnuar si specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë**, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.10327, date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM-së nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier", të pajisur me certifikatë në lidhje me frekuentimin e kurseve të formimit në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës;
 - b) **2 (dy) punonjës të trajnuar për punime në lartësi, të pajisur me certifikatën përkatëse në lidhje me frekuentimin e kurseve;**
 - c) **5 (pesë) punonjës bojaxhi.**
 - d) **1 (një) punonjës murator.**

Për të provuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat Individuale të Punës të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik në punë/ Kartelat personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga një organ i akredituar certifikues personeli (Trup Certifikuese), në bazë të Ligjit nr.8734 datë 01.02.2001 "Per garantimin e sigurise se punes te pajisjeve te instalimeve elektrike", i ndryshuar dhe te VKM-se nr.42, date 16.01.2008 "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te subjekteve juridike, qe ushtrojne veprimtari ndertimi", i ndryshuar, për punonjësit e përcaktuar në gërmat "c" deri në "d".

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë sesa një kualifikim/ trajnim nga ato të kërkuara më sipër.

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të provojë mundësinë e disponimit, të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Kamion vetshkarkues	copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncine	copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Autovinc (me kosh)	copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Gjenerator/motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Kokore	copë	10	Në pronësi ose me qira
6	Jelek fosforeshentë	copë	10	Në pronësi ose me qira
7	Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt	copë	5	Në pronësi ose me qira
8	Depozite uji 5000 l minimumi	copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Fikëse zjarri e lëvizshme	copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Skeleri	m2	500	Në pronësi ose me qira

Për të provuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen e makinerive dhe pajisjeve:

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose fatura e blerjes ose dokument zhdoganimi ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

➤ Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje.

- b) Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen e automjeteve:

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

c) Leje qarkullimi e mjetit.

d) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

e) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve rrugore,

f) Certifikate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1,500 kg).

7. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës përcakton personin përgjegjës për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes.

8. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Dokumentat standarde të tenderit

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kritereve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 e seksionit 2.3, të kritereve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kritereve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kritereve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 8

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

LOTI II " MIRËMBAJTJE OBJEKTI NDËRTIMOR PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË REZERVAVE MATERIALE TË SHTETIT"

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PRANIMIT/KUALIFIKIMIT

Ofertuesi duhet të deklarojë se:

- a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 "Për Organizatat jo Fitimprurëse".
- b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)
- c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,
- ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.
- d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 7.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër.

Vec kesaj, nëse oferta dorëzohet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, duhet te dorezohen:

- a. Marrëveshja e noterizuar sipas së cilës bashkimi i operatorëve ekonomikë është krijuar zyrtarisht;
- b. Prokura e posaçme.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formulari i Ofertës, sipas Shtojcës 1;*
- b. *Deklaratën për paraqitje oferte të pavarur, sipas Shtojcës 1/1*
- c. *Deklaratë mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, sipas Shtojcës 5;*
- ç. *Deklaratë mbi Konfliktin e Interesit, sipas Shtojcës 6;*

d. Deklaratë mbi garantimin e zbatueshmërisë së dispozitave ligjore në marrëdhëniet e punës sipas Shtojces 7/1;

dh. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.

3. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

3.1 Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shoqërisë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 9001 ose ekuivalente**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton cilësinë e menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 18001 / ISO 45001 ose ekuivalente**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.
3. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatë që vërteton sistemin e menaxhimit të mjedisit, sipas standardit ndërkombëtar **ISO 14001 ose ekuivalente**. Certifikata duhet të jetë në fuqi, e vlefshme në ditën e hapjes së procedurës dhe të jetë e lëshuar nga një organ i vlerësimit të konformitetit i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtar akreditues, të njohura nga Republika e Shqipërisë. Qëllimi i certifikimit të operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë në fushën e objektit që prokurohet.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, secili anëtar i bashkimit të operatorëve ekonomik duhet të dorëzojë certifikatat e mësipërme ISO, sipas zërave të punëve/mallrave/shërbimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas aktmarrëveshjes, në përputhje me nenin 74 të VKM-së nr.914 datë 29.12.2014, i ndryshuar.

3.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë kopje të deklaratave të xhiros vjetore ose vërtetim të lëshuar nga administrata tatimore, për xhiron e realizuar **në tre vitet e fundit 2018, 2019 dhe 2020**, vlera mesatare e të cilës të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të Lotit 2.
2. Operatori ekonomik duhet të dorëzojë kopje të certifikuar të bilanceve **të tre viteve të fundit (2018, 2019 dhe 2020)**, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. *Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar.*

3.3 Kapaciteti teknik:

1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë 3 (tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës, në vlerën prej minimalisht 40% të vlerës së

Dokumentat standarde të tenderit

fondit të marrëveshjes kuadër. Këto shërbime të ngjashme duhet të vërtetohen me dokumentacionin si më poshtë:

- a) vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara, kur këto shërbime të ngjashme janë realizuar me institucione publike.
 - b) faturat përkatëse tatimore të shitjes, ku shënohen datat dhe shumat për shërbimet e realizuara, kur këto shërbime të ngjashme janë realizuar me subjekte private.
2. Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Liçencë profesionale të shoqërisë**, të lëshuar nga institucioni përgjegjës i ngarkuar me ligj, të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës, ku të përfshihen të paktën **kategoritë** e mëposhtme:
- NP 3-A Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada.
 - NS 4-A Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastike, metalike dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese.
3. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar, **3 (tre) muajt e fundit referuar listëpagesës, mesatarisht 6 punonjës, për periudhën Janar - Mars 2021**. Për të provuar pasjen e tyre, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentat e mëposhtme:
- a) Listëpagesat e deklaruara të punonjësve, sipas formatit E-Sig 025/a, për periudhën **Janar - Mars 2021** të konfirmuara nga administrata tatimore.
 - b) Vërtetim për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore, të lëshuar nga administrata tatimore, për periudhën **Janar - Mars 2021**
4. Operatori ekonomik duhet të ketë në stafin e tij teknik, të punësuar me kohë të plotë referuar listëpagesës, për periudhën **Janar - Mars 2021** minimalisht :
- a) **1 (një) punonjës të kualifikuar si specialist/ ekspert zjarrefikës, në fushën e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin**, në përputhje me pikën 4, të nenit 49, të Ligjit Nr.152/2015 “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”, të pajisur me certifikatën përkatëse të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin;
 - b) **1 (një) punonjës të trajnuar si specialist për sigurimin teknik dhe shëndetin në punë**, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr.10327, date 18.02.2010 "Per sigurine dhe shendetin ne pune" dhe VKM-së nr.312, date 05.05.2010 "Per miratimin e e rregullores "Per sigurine ne kantier", të pajisur me certifikatë në lidhje me frekuentimin e kurseve të formimit në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës;
 - c) **1 (nje) punonjës të trajnuar për punime në lartësi, të pajisur me certifikatën përkatëse në lidhje me frekuentimin e kurseve;**
 - d) **1 (një) punonjës bojaxhi.**
 - e) **2 (dy) punonjës murator.**

Për të provuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Kontratat Individuale të Punës të vlefshme në kohën e zhvillimit të procedurës.
- Dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik në punë/ Kartelat personale të sigurimit teknik, të lëshuara nga një organ i akredituar çertifikues personeli (Trup Certifikuese), në bazë të Ligjit nr.8734 datë 01.02.2001 "Per garantimin e sigurise se punes te pajisjeve te instalimeve elektrike", i ndryshuar dhe te VKM-se nr.42, date 16.01.2008 “Per miratimin e rregullores per kriteret dhe procedurat e dhenies se licencave

Dokumentat standarde të tenderit

profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndertimi”, i ndryshuar, për punonjësit e përcaktuar në gërmat “d” deri në “e”.

Shënim: Një punonjës mund të ketë më shumë sesa një kualifikim/ trajnim nga ato të kërkuara më sipër.

6. Operatori ekonomik duhet të disponojë ose të provojë mundësinë e disponimit, të makinerive, pajisjeve dhe mjeteve, si më poshtë:

Nr	Emri i mjetit	Njësia	Sasitë minimale	Statusi
1	Kamion vetshkarkues	copë	1	Në pronësi ose me qira
2	Kamioncine	copë	1	Në pronësi ose me qira
3	Autovinc (me kosh)	copë	1	Në pronësi ose me qira
4	Gjenerator/motogjenerator	copë	1	Në pronësi ose me qira
5	Kokore	copë	10	Në pronësi ose me qira
6	Jelek fosforeshentë	copë	10	Në pronësi ose me qira
7	Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt	copë	5	Në pronësi ose me qira
8	Depozite uji 5000 l minimumi	copë	1	Në pronësi ose me qira
9	Matrapik	copë	1	Në pronësi ose me qira
10	Trapan	copë	1	Në pronësi ose me qira
11	Betoniere	copë	1	Në pronësi ose me qira
12	Fikëse zjarri e lëvizshme	copë	1	Në pronësi ose me qira
13	Skeleri	m2	500	Në pronësi ose me qira
14	Prerëse hekuri	copë	1	Në pronësi ose me qira

Për të provuar këtë, operatori ekonomik duhet të paraqesë:

a) Dokument që vërteton pronësinë ose huapërdorjen ose qiramarrjen e makinerive dhe pajisjeve:

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose fatura e blerjes ose dokument zhdoganimi ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë, sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

➤ Dokumentacioni që vërteton huapërdorjen:

- Kontratë huapërdorje.

b) Dokument që vërteton pronësinë ose qiramarrjen e automjeteve:

➤ Dokumentacioni që vërteton pronësinë:

- Çertifikata e pronësisë e lëshuar nga institucioni i autorizuar me ligj ose kontrata e shitblerjes ose kontrata e dhurimit ose çdo dokument tjetër me anë të të cilit fitohet e drejta e pronësisë sipas Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë.

➤ Dokumentacioni që vërteton marrjen me qira:

- Kontratë qiraje.

c) Leje qarkullimi e mjetit.

d) Certifikatë e kontrollit teknik të mjeteve rrugore,

Dokumentat standarde të tenderit

- e) Policë për sigurimin e detyrueshëm të mjeteve rrugore,
 - f) Certificate për transport mallrash (e detyrueshme vetëm për mjetet me kapacitet transportues mbi 1,500 kg).
7. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës përcakton personin përgjegjës për ndjekjen e kryerjes së shërbimeve të mirëmbajtjes.
8. Operatori ekonomik, duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër kryerjen e shërbimeve të mirëmbajtjes, nga punonjës të pajisur me uniformën e punës, me materiale/ pajisje mbrojtëse personale për shëndetin dhe sigurinë teknike në punë.

Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 e seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim.

Shtojca 9

[*Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti Kontraktor*]

SPECIFIKIMET TEKNIKE

KUJDES

Loti II " Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit"

BASHKENGJITUR

Specifikimet teknike nuk duhet të kenë asnjë kërkesë apo referencë të ndonjë markë apo emër i veçantë, patentë, vizatim ose tip, origjinë specifike, prodhues ose sipërmarrës shërbimi, përveç rasteve kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme, e përshkrimit të kërkesave, me kusht që fjalët "ose ekuivalent" të përfshihen detyrimisht në këto specifikime.

Shtojca 10

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në marrëveshjen kuadër]

**PLANIFIKIMI I
KONTRATAVE NË MARRËVESHJEN KUADËR**

<input type="checkbox"/> Shërbim: Numri total i kontratave sipas Marrëveshjes Kuadër _____		
Kontrata Nr.	Titulli i Kontratës	Përshkrim i shkurtër i kontratës
01	_____	_____
02	_____	_____
03	_____	_____
...	_____	_____

Shtojca 11

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMI

Shërbimi që kërkohet:

Loti I "Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë"

Nr	Emërtimi (Zerat e punes)	Njësia	Sasite e pritshme
1	Lyerje godine Kati (0,1,2,3,4)	m ²	19540
2	Lyerje dyer druri	m ²	200

Afatet e ekzekutimit:

- **Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.**

Shtojca 11*(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)**(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)***SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMI**

Shërbimi që kërkohet:

Loti II " Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit"

Nr	Emërtimi (Zerat e punes)	Njësia	Sasite e pritshme
Magazina nr. 1 (Mborje) Korçë			
1	Boje hidroplastike nga brenda	m ²	680
Magazina nr. 3 (Mborje) Korçë			
2	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1shtrese k. katrama	m ²	420
Magazina nr. 1 (Pukë)			
3	Boje hidroplastike nga brenda	m ²	1332.68
4	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1shtrese k. katrama	m ²	423.5
5	F.V xhama per dritaret	m ²	31
6	Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, Ilaç perzier M 25	m ²	16.4
Magazina nr. 3 (Pukë)			
7	Shtrese betoni C6/10	m ³	2
Objekti nr. 8 (park automjetesh) Vlore			
8	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1shtrese k. katrama	m ²	9
Objekti nr. 10 (depo) Vlore			
9	Suva brenda mur tulle h~4m me pompe, Ilaç perzier M 25	m ²	35.48
10	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1shtrese k. katrama	m ²	196.8
11	Boje hidroplastike	m ²	35.48
Objekti nr. 11 (mence, kuzhine) Vlore			
12	Suva e zakonshme fasade mur tulle h ~ 8 m	m ²	26.21
13	Boje hidroplastike nga jashte	m ²	112.98
Objekti nr. 12 (fjetine) Vlore			
14	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 1shtrese k. katrama	m ²	20.52

Afatet e ekzekutimit:

- Nga lidhja e kontratës/ kontratave deri në plotësimin e nevojave të autoritetit kontraktor, në bazë të marrëveshjes kuadër.

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Loti I "Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë"

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Shërbimi që kërkohet: Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. –
Marrëveshje Kuadër - me disa operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës

Shtojca 12

(Shtojcë për t'u plotëesuar nga Autoriteti Kontraktor)

TERMAT E REFERENCËS

Loti II " Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit"

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Shërbimi që kërkohet: Mirëmbajtje objekti ndërtimor për Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit – **Marrëveshje Kuadër - me disa operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.**

Afatet e ekzekutimit: 12 muaj nga data e lidhjes së kontratës

Shtojca 13

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor]

NJOFTIM STANDARD PËR OFERTUESIN E SKUALIFIKUAR⁴

[Vendi dhe data]

[Emri dhe adresa e autoritetit kontraktor]

[Adresa e ofertuesit]

I/E Nderuar, Z/Zj. <emri i kontaktit>

Ju falenderoj për pjesëmarrjen në procedurën e lartpërmendur të prokurimit publik. Procedura e kryer në përputhje me Ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” .

Oferta juaj u vlerësua me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e ofertës. Me keqardhje ju informoj se u s'kualifikuat, sepse oferta e dorëzuar nga ju u refuzua për shkak të arsyes (-ve) së/të mëposhtme :

Nëse mendoni se Autoriteti Kontraktor ka shkelur LPP ose RrPP gjatë procedurës së prokurimit publik, atëherë keni të drejtë të filloni një procedurë rishikimi sic parashikohet në Kreun VII të LPP.

Edhe pse nuk mundëm të përdornim shërbimet tuaja në këtë rast, besoj se do të vazhdoni të jeni i interesuar në nismat tona të prokurimit.

Me respekt

< Emri >

⁴ Ky njoftim duhet të përdoret në rastin e procedurave të prokurimit që zhvillohen në rrugë shkresore

Shtojca 14

[Shtojcë për t'u plotësuar Autoriteti Kontraktor]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

[Data _____]

Për: [Emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues]

Procedura e prokurimit:

Numri i referencës së procedurës/lotit:

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [Sasia ose qëllimi dhe kohëzgjatja e kontratës]

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët oferta ekonomikisht më e favorshme

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ numri i NIPT-it _____

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë [emri dhe adresa e ofertuesit të shpallur fitues] se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej [shuma përkatëse e shprehur në fjalë dhe shifra]/pikët totale të marra [_____] është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë [emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit] sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej [vlera përkatëse e shprehur

Dokumentat standarde të tenderit

në fjalë dhe shifra], siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 15

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti Kontraktor në rastin e marrëveshjes kuadër]

FORMULARI I NJOFTIMIT TË OPERATORËVE EKONOMIKË TË SUKSESSHËM NË MARRËVESHJEN KUADËR

[Data]

Për: [Emri dhe adresa e operatorëve ekonomikë të shpallur fitues]

1. _____
2. _____
3. _____

* * *

Procedura e prokurimit: _____

Numri i referencës së procedurës/lotit: _____

Përshkrim i shkurtër i kontratës: *[Sasia, objekti, kohëzgjatja e kontratës etj]*

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: oferta ekonomikisht më e favorshme çmimi më i ulët

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë këta operatorë ekonomikë, me shumatoren e çmimeve për njësi të ofruar/ me vlerat përkatëse të ofruara:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/vlera _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Janë skualifikuar operatorët ekonomikë të mëposhëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë *numri i NIPT-it*

Perkatësisht për arsyet e mëposhtme:

* * *

Dokumentat standarde të tenderit

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë se janë identifikuar si operatorë ekonomikë të suksesshëm:

1. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

2. _____
Emri i plotë i shoqërisë _____ *numri i NIPT-it* _____

Shumatorja e çmimeve për njësi të ofruar/Vlera _____/Pikët totale të marra _____
(me numra dhe fjalë)

Etj. _____

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqiteni pranë [*emri dhe adresa e autoritetit kontraktor dhe referenca e kontaktit*], brenda _____ ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi për të lidhur draft marrëveshjen.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë _____

Ankesa: ka ose jo _____
(nëse ka) ka marrë përgjigje në datë _____

[Titullari i autoritetit kontraktor]

Shtojca 16

KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES Shërbimet – Procedura e Hapur

Neni 1 Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Shërbimeve të prokuruar me anë të procedurës së hapur.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërisë parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

